REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**
**K.P.P 802/2019**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Evis Shurdha | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 24.12.2019, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: "Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k., në procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur"*, me nr. *REF-35460-09-10-2019*, me objekt *"Punime ndërtimi për eleminimin e Pikave të Zeza në rrugë (Bashkëfinancim IPA 2013, Siguria Rrugore)"*, me fond limit 39.045.776,98 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** "I.D.K Konstruksion" sh.p.k.
Rruga "Zaja", Kodër Bërxullë, Autostrada Tiranë – Durrës, Km.12, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga "Sami Frashëri", Nr.33, Tiranë

**Subjekte të interesuar:** Bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k.
Tiranë, Autostradë Km.2

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 11.09.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *"Procedurë e hapur"*, me nr. *REF-35460-09-10-2019,* me objekt *"Punime ndërtimi për eleminimin e Pikave të Zeza në rrugë (Bashkëfinancim IPA 2013, Siguria Rrugore)",* me fond limit 39.045.776,98 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datën 21.10.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informaconit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Biba X" sh.p.k. & "Lala" sh.p.k.
   33.006.341,55 lekë, skualifikuar
2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. 37.093.471,28 lekë, kualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Everest" sh.p.k. & "V.A.S Konstruksion" sh.p.k.
   37.990.696,8 lekë, skualifikuar
4. "I.D.K Konstruksion" sh.p.k. 38.915.176,17 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 29.10.2019 operatori ekonomik ankimues "I.D.K Konstruksion" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 05.11.2019, operatori ekonomik ankimues "I.D.K Konstruksion" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:
*[...]*
*Duke pasur ne konsiderate neuin 53, pika 3, te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin puhlik", i cili parashikon se Autoriteti kontraktor, ne zbatim tc pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji, dhe nga te dhenat qe disponohen nga ana jone, konstatojme qe ky BOE nuk ploteson kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, prandaj duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure prokurimi.*
*2. l Bazuar ne informacionet e marra nga Vendimet e Komisionit te Prokurimit Publik, ne te cilat subjekti Ndregjoni shpk, pjese e BOE "R.S & M" & "SI-SI AL" shpk & "Ndregjoni" shpk ka qene pale ankimuese por edhe ne cilesine e pales se interesuar, kemi konstatuar se ne disa raste operatori ekonomik Ndregjoni shpk eshte skualifikuar per eospermbushje te kriterit «Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore, ne te gjitha vendet ku operatori ushtron apo ka ushtruar aktivitet, sipas ekstratit te QKR». Per keto arsye dyshojme se Operatori ekonomik Ndregjoni shpk, pjese e ketij bashkimi OE, nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.2.3, te kritereve te vecanta per kualifikim (per pagesen e taksat vendore ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2017 dhe 2018).*
*2.2 Ne piken 2.3.2 te kritereve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje: 2.3/2 Licence te vlefshme te shoqerise, per zbatim te punimeve (konform VKM-se nr. 42 date 16.01.2008, e ndryshuar) me kategorite e meposhtme. [ ... ] Shqyrtimi dhe vleresimi i licencave duhet te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne VKM-ne e siperpermendur. Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri, dyshojme se Operatori Ndregjoni shpk, pjese e BOE*

*"R.S & M"& "SI-SI AL" shpk &"Ndregjoni" shpk nuk ka paraqitur licensen perkatese konform legjislacionit shqiptar.*

*Sipas ekstraktit te QKB-se si drejtues ligjor qe nga data 20.03.2019 eshte shtuar edhe z. Bledar Alstafa. Nderkohe qe bazuar ne informacionet e disponuara nga adresa zyrtare ëëë.infrastruktura.gov.al, verehet se, ka mosperputhje te drejtuesit ligjor te pasqyruar ne license me drejtuesin ligjor sipas ekstraktit te QKB. Ne kreun III "Kategorizimi dhe klasifikimi i licences, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 germa "a", paragrafi 2 te VKM Nr.42, date16.l.2008 "parashikohet se: 2. Elementet e licences: a) Licenca permban keto elemente: 1. Kategorite e punimeve te ndertimit (percaktuar ne lidhjen nr.Z); II. Klasifikimin me nivele per cdo kategori (percaktuar ne lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV. Daten e regjistrimit ne Regjistrin Themeltar (e njejte me daten e marrjes se vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjore e teknike; VI. Seline; VII. Afatin e vlefshmerise; VIII. Elementet e sigurise te percaktuara me urdher te ministrit; IX.Te dhenat e plota te kategorive dhe klasifikimit, ne pjesen e pasme te licences (Lidhjet 2 e 4 te kesaj rregulloreje), "[...] Ne kreun I "Qellimi, fusha e veprimit te rregullores dhe perkufizime" pika 2 te VKM Nr.42, date 16.1.2008 "parashikohet se: "Drejtues ligjor-personi fizik apo personat fizike (administrator per sh.p.k., drejtor, presidenti per sh.a., personi fizik) te percaktuar si te tille nga vendimi i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit ose ne gjykate Kreu II, pika 5, ku thuhet "Brenda 30 diteve, cdo subjekt i licencuar ne zbatim ka detyrimin te depozitoje aplikimin per perditesimin e te dhenave qe nuk sjellin ndryshim ne klasifikim . I. Ndryshim apo shtese te drejtuesit/ve ligjor te shoqerise; dhe ne vijim kreu VII percakton se "Shoqeria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit te caktuara ne kete rregullore. Ne kete rast komisioni heq licencen per shoqerine/drejtuesit per nje periudhe 3 vjet".*

*Licenca e paraqitur nga ky subjekt megjithese eshte leshuar nga institucioni pergjegjes shfaq te meta dhe nuk permbush te gjithe detyrimet ligjore te parashikuara nga akti normativ ne zbatim te ligjit, VKM Nr.42, date 16.1.2008 "Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Kjo sepse; z. Bledar Alstafa eshte emeruar administrator me date 20.03.2019 dhe referuar detyrimeve te mesiperme ligjore, OE duhej qe brenda dates 19.04.2019 (brenda 30 diteve) te pasqyronte ndryshimet perkatese ne licensën e shoqerise. Por, megjithese ka kaluar afati ligjor per te pasqyruar ndryshimet ne drejtuesit ligjore, ai nuk ka bere ndryshimin e kerkuar nga baza ligjore ne fuqi. Perputhja e drejtuesve ligjore sipas QKB-se dhe licenses se shoqerise nuk kushtezohet e nuk lidhet me kompetencat qe sipas satutit i eshte caktuar njerit apo tjetrit administrator. VKM dhe Ligji 9901/2008 "per shoqerite tregetare" e percakton qarte se, secili administrator, pavaresisht kompetencave eshte drejtus ligjor dhe si i tille duhet te jete medoemos edhe ne licensen e shoqerise. Referuar pikes 5 germes (a) dhe (b) te Kreut II te VKM nr 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", eshte detyrim ligjor i cdo subjekt te licencuar ne zbatim qe te aplikoje per perditesimin e te dhenave.*

*Ne rregullat e prokurimit percaktohet se, operatoret ekonoeike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne legjislacionin ne fuqi si edhe kriteret e*

*kualifikimit te vendosur nga autoriteti kontraktor. Shqyrtimi dhe vleresimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne same siper (pra VKM nr 42 date 16.1.2008) Per same siper, dokumentacioni i paraqitur nga ky subjekt, ne kete procedure prokurimi, nuk ploteson kerkesat legjislacionit ne fuqi dhe nuk mund te konsiderohet i vlefshem, I njejti qendrim eshte mbrojtur rigorozisht ne praktiken e vendimarrjeve te tjera te Autoritetit Rrugor Shqiptar, po keshtu dhe te KPP-se si organi me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve sic jane vendimet 55/2016; 203/2016 dhe 50212017.*

*2.3 BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi nuk ka arritur te permbushe kriterin e percaktuar ne piken 2.3.13, ku thuhet: [..] Ne rastin e Bashkimit le Operatoreve Ekonomike, kandidatet/ofertuesit duhet t 'i permbahen nenit 74 te VK.M-se nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", e ndryshuar [...].*

*Neni 74/2, "Bashkimi i operatoreve ekonomike". Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemanjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje seci/i 11ga auetaret e ketij hashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetaret e bashkimit caktojne me prokuren qe perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. [...]*

*Bazuar ne investigimet e bera ne dokumentacione zyrtare te leshuara nga Institucione Shteterore si: KLSH, APP, KPP etj, problematika te shfaqura ne eksperinca te ngjashme te secilit prej anetareve te ketij bashkimi, si pjesemarres aktive ne tendera nepermjet kontratave te bashkepunimit me subjekte te tjere, si dhe duke marre ne konsiderate kompleksitetin e ketij projekti, dokumentet e procedures se prokurimit, kriteret e kualifikimit, fakti qe oferta eshte paraqitur nga 3 shoqeri (cka kerkon nje nivel te larte profesional per pergatitjen e dokumentacionit) me aktivitete dhe veprimtari te ndryshme, pretendojme qe marreveshja e bashkepunimit te mos jete bere ne perputhje me kete percaktim. Pra, argumentat e mesiperme na cojne ne konkluzione se Kontrata e bashkepunimit nuk eshte ndare ne elemente konkrete sic kerkohet me siper, nuk jane percaktuar te gjithe zerat e projektit se nga cili anetar i bashkimit do te zbatohen ne rast te shpalljes fitues, si dhe mund te kete problematika qe lidhen me gabime aritmetike ne oferte, gabime ne volume, njesi matese etj, fakte keto qe na bejne te dyshojme se BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi, mund te kete nderhyre ne preventivin e dhene nga AK-ja, dhe do te mjaftonte vetem kjo arsye per skualifikim nga kjo procedure prokurimi. Veprime keto ne kundershtim me VKM- ja nr.514, date 15.8.2007, "Per informatizimin e llogaritjes se kostos dhe hartimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit", i ndryshuar, qe ne piken 12 percakton: Te gjitha institucionet shteterore, qe kryejne prokurime te punimeve te ndertimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatore te huaj, detyrohen te kontrollojne cmimet per zerin e punes, te ofertave te paraqitura ne tender, me cmimet e bazuara ne manualin e cmimeve te ndertimit dhe te analizat teknike te ketyre cmimeve. Ne rastin kur zeri I punes nuk figuron ne manual, institucioni u kerkon subjekteve ofertuese te paraqesin analizen teknike, bazuar ne metodologjine e percaktuar ne udhezimin nr. 2, date 8.5.2003 te Keshillit te Ministrave dhe te paraqitur me formayin e unifikuar. Nje fotokopje te analizave te paraqitura nga subjektet ofertuese per zerin e punes, institucioni ia*

*dergon ministrise, e cila e shqyrton analizen e re dhe nese e gjykon te drejte, e reflekton cmimin ne manualin e cmimeve te periudhes vijuese... ".*
*Per sa me siper, arsyetojme se, si rrjedhoje e gabimeve te konstatura dhe analizuara me siper na lindin dyshime te arsyeshme se keto subjekte nuk kane permbushur kriteret e percaktuara ne DST, sipas parashikimeve te bera ne nenin 74 pika 3 te Vendimit Nr. 914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" te ndryshuar, i cili parashikon se "3. Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ala te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbim apo furnizim, te percaktuara ne aktmarreveshje. Kerkojme nga ana juaj te behet ky verifikim dhe do te konstatoni qe argumentimi yne eshte i drejte dhe ligjor.*
*3. BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi nuk ka arritur te permbushe kriterin e percaktuar ne piken 2.3.11, "Si deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, kandidati/ofertuesi duhet te paraqese [...].*
*Makineri per aplikim vijezimi termoplastik, kapacitet mbajtes te bojes mbi 4.5 ton, pronesi ose qira, Cope 2 [...].*
*Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe verteton pronesine e mjetit: certifikaten e pronesise; lejen e qarkullimit; certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshem te mjetit; lejen e transportit qe leshohet nga njesia vendore dlte foto/perkatese; Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur Jane ne pronesi, duhet te paraqitet kontrata e blerjes apo fatura e zhdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese.*
*Per mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve. Duke qene se jemi nje nder shoqerite me te medha ne Republiken e Shqiperise, lider ne fushen e sinjalistikes, me nje shtrirje territoriale te projekteve tona pergjate gjithe territorit te vendit, kontraktor te subjekteve juridike publike dhe private, duke patur njohuri te plota mbi tregun, partneret, konkurentet dhe kapacitetin e tyre teknik si dhe te dhenave qe kemi marre rezulton qe Makineri per aplikim vijezimi termoplastik, kapacitet mbajtes te bojes mbi 4.5 ton, ne vendin tone jane te rregjistruara vetem tre mjete te tilla. Si rrjedhim i kesaj, e vetmja forme disponimi eshte qeraja nga jashte vendit. Paraqesim verejtjet tona nese keto kontrata jane noteriale, sic kerkohet ne DST, pra qe noteri te vertetoje disponimin e mjetit dhe a rezultojne te jene te certifikuara "Apostille", ne perputhje me kriterin 2.3.12 te DST-ve. Ne te kundert kerkojme te verifikohen kontratat origjinale nga ana juaj, pasi sic jemi mesuar tashme mjetet e marra nga jashte rezultojne kryesisht deklarime te rreme per qellime kualifikimi.*
*4. Gjithashtu ngreme dyshime te bazuara se bashkimi te perkoheshem i shoqerive, nuk permbush kriterin e percaktuar ne pi ken 2. 3 te Dokumentave Standarte te Tenderit, Kapaciteti Teknik.... Deshmi se ka realizuar pune te ngjashme per te njejtin objekt, ne raport me perqindjen e pjesemarjes se tij ne bashkim, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit. Nga verifikimi qe ne kemi kryer ne Buletinin e Njoftimeve Publike te Agjencise se Prokurimit Publik, te dhenat e deklaruara ne faqen zyrtare ëëë.opencorporates.al mbi eksperiencen e*

*deritanishme te ketij subjekti duke nisur nga viti 2016 e ne vijim, konstatojme se te vetmet kontrata publike te lidhura nga shoqeria "SI- SI-AL" shpk jane ato te cilat jane kryer ne bashkepunim me shoqerine "RS&M" shpk ku % me te madhe ne kontratat e bashkepunimit e ka kjo e fundit.*
*Ne lidhje me permbushjen e kriterit te mesiperm kemi dyshime te arsyeshme, se anetari i bashkimit te operatoreve ekonomike "SI SI AL" shpk nuk permbush kapacitetin teknik deshmi te kontratave te ngjashme. Shoqeria "SI SI AL" shpk , nuk disponon kontrata te ngjashme ne perputhje me zerat e preventivit dhe % e bashkepunimit te marre persiper, pasi kontratat e saj kryesisht Jane furnizime mallrash, te cilat nuk mund te konsiderohen te ngjashme ne punime te sinjalistikes, ose kontrata te realizuara ne sektorin privat, por qe nuk jane shoqeruara me te gjithe dokumentacionin e kerkuar nga A.K.*
*AK-ja ne cdo rast duhet qe te beje vleresimin ne baze te kritereve te hartuara ne dokumentat e tenderit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, tc cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit, Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", I ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit.*
*Rrjedhimisht, sa me siper argumentuam qe vendimi i AK-se, ne lidhje me kualifikimin e BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, eshte kryer ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik, dhe si i tille duhet te skualifikohet.*
*Referuar frymes se legjislacionit per prokurimet publike vendosja e kritereve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t' i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve te operatorit ekonomik te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.*
*Nenvizojme faktin se ne nenin 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" parashikohet se: Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet percaktuara ne njoftintin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji. Per sa mesiper kerkojme:*
*• Bazuar ne parimet baze te prokurimit publik, kerkojme skualifikimin e ofertes se paraqitur nga BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, pasi nuk ploteson kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit.*
*• Riklasifikimin e ofertave te paraqitura mbi bazen e ketij vendimi.*

II.5. Me shkresën nr. 10173/2 prot., datë 11.11.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën. Konkretisht, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

*[…]*

*III. 1. Lidhur me pretendimin e operatorit "I.D.K KONSTRUKSION " sh.p.k , se ; "[ ... ] Ndregjoni shpk , pjese e BOE "R.S & M+SI.SI-AL+NDREGJONI" nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.2.3, te kritereve te vecanta per kualifikim (per pagesen e taksave vendore ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2017 dhe 2018 [...] , Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se:*

*III.I.I. Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 12, kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 2.3.3, e kapacitetit ekonomik dhe financiar eshte kerkuar: "Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vile/ 2017 dhe 2018".*

*III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te bashkimit te operatoreve ekonomike BOE "R.S & M+SI.SI AL+NDREGJON" rezulton se, eshte paraqitur dokumenti Kontrate Bashkepunimi e noterizuar , ndermjet shoqerise "R.S & M" sh.p.k., shoqerise "SI.SI-AL" sh.p.k. dhe shoqerise "Ndregjoni", nga ku shoqeria "R.S & M" sh.p.k. merr persiper te kryeje 59 % te punimeve, shoqeria SI.SI-AL" sh.p.k. merr persiper te kryeje 20% te punimeve dhe shoqeria "Ndregjoni" merr persiper te kryeje 21 % te punimeve. Gjithashtu eshte paraqitur edhe dokumenti Prokure e Posacme, sipas se ciles shoqeria "R.S & M" sh.p.k. eshte perfaqesuese e ketij bashkimi operatoresh ekonomike.*

*III.1.3. Nga verifikimi i kryer tek dokumentat e hedhura ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton qe ne permbushje te ketij kriteri ofertuesi Ndregjoni shpk, pjese e BOE "R.S & M+SI.SI-AL+NDREGJONI" ka paraqitur:*

*I. Vertetim nr 241969/ I prot.,date 19.10.2018 nga Bashkia Tirane, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore per likujdimin e detyrimeve vendore per vitin 2018.*

*2. Vertetim nr 120929/1 prot.,date 05.04.2017 nga Bashkia Tirane, Drejtoria e Pergjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore per likujdimin e detyrimeve vendore per vitin 2017.*

*Sipas Ekstraktit historik i regjistrit tregetar per te dhenat e subjektit shpk Ndregjoni me NUIS KJ 13290481I, nga faqja zyrtare e inteeetit te QKB rezulton se: "Zyra qendrore e shoqerise ne Shqiperi Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr. 8, Rruga Sule Bega, Ndertesa Nr. 32, Hyrja 8 . Vende te tjera te ushtrimit te aktivitetit Tirane Farke FARKE E VOGEL Rruga Daxhit, Zona Kadastrale Nr. 1605. numri i pasurise 210/ IO dhe 210/ 11, Tirane , shtuar 28/03/2019. "*

*III.1.4. Ne Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatoreve ekonomike", pika 1 e VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe ne rast perzgjedhjeje edhe gjate zbatimit te kontrates. Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi". Ne Kreun VIII, neni 74, pika 2 po ketu, parashikohet: "Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet*

*konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetaret e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. .. ", ndersa ne piken 3 parashikohet: "Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjeseearrjes ne pune, sherbie apo fumizim, te percaktuara ne aktmarreveshje".*

*III.1.5. Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese." Ndersa ne nenin 53, pika 3 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentat e tenderit ...",*

*III.1.6. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshee te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonoeike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.*

*III.1.7. Referuar same siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses konstaton se, ne kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, autoriteti kontraktor ka kerkuar shprehimisht nga operatoret ekonomike pjesmarres duhet te paraqesin nje deklarate me shkrim nga administratori i subjektit si dhe vertetim te leshuar nga cdo njesi vendore per te deshmuar se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2017 dhe 2018.*

*Per sa i perket operatorit ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k., si anetar i bashkimit te perkoheshem te shoqerive, nga shqyrtimi i Ekstraktit te Regjistrit Tregetar te kesaj shoqerie, rezulton se, kjo e fundit ushtron aktivitet ne Republiken e Shqiperise me Zyre Qendrore ne Tirane, Njesia Bashkiake nr.8, Rruga "Sule Bega", ndertesa nr.32, hyrja 8, si edhe referuar ketij Ekstrakti ka Yende te tjera te ushtrimit te aktivitetit Tirane Farke FARKE E VOGEL Rruga Daxhit, Zona Kadastrale Nr. 1605, numri i pasurise 210/10 dhe 210/11, Tirane, shtuar 28/03/2019. Nga shqyrtimi i Ekstraktit Historik te kesaj shoqerie, rezulton se per vitet 2017, 2018, kjo e fund it ka ushtruar aktivitet ne Bashkine Tirane.*

*Operatori ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k. ne permbushje te kriterit te mesiperm ka dorezuar vertetime te leshuara nga Bashkia Tirane, me ane te te cilave vertetohet se kjo shoqeri nuk ka detyrime te taksave dhe tarifave vendore te pashlyera ne kete Bashki per vitet 2017, 2018 .*

*Sa me siper, nga shqyrtimi i ekstraktit historik te shoqerise, te leshuar nga QKB dhe vertetimeve te leshuara nga institucioni vendor i bashkise ku operatori ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k. ka ushtruar aktivitet, rezulton se ky i fundit ka vertetuar se ka shlyer detyrime lidhur me taksat dhe tarifat vendore per vitet 2017, 2018, ne te gjitha vendet ku ka ushtruar aktivitetin e tij tregtar, konkretisht per Bashkine Tirane. Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses arsyeton se, duke qene se sipas legjislacionit ne fuqi, Qendra Kombetare e Biznesit ka funksion te mbaje regjistrin tregtar, ne perputhje me ligjin qe rregullon regjistrimin e biznesit, te kryeje regjistrimet ne regjistrin tregtar, te kryeje regjistrimin e subjekteve te percaktuara ne ligjin qe rregullon regjistrimin e biznesit, per qellim te regjistrimit fiskal, te sigurimeve shoqerore e shendetesore, si dhe te inspektimit te marredhenieve te punes, te leshoje certifikata, ekstrakte te regjistrimeve dhe kopje te vertetuara te akteve te depozituara, te publikoje te dhenat e regjistruara, sipas ligjit qe rregullon regjistrimin e biznesit, si dhe siguron aksesin e lire te publikut ne to, atehere edhe verifikimi i vendeve ku shoqeria "Ndregjoni" sh.p.k. ka kryer aktivitetin e saj gjate vitit 2017, 2018 do te behet referuar ekstraktit te publikuar nga QKB per kete shoqeri.*
*Sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses gjykon se operatori ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k. si nje nga anetaret e bashkimit te perkohshee te shoqerive, ka dorezuar dokumentacionin e kerkuar lidhur me shlyerjen e detyrimeve vendore ndaj vendeve ku ka ushtruar aktivitet per vitin 2017, 2018, pra, rrjedhimisht, operatori "Ndregjoni" sh.p.k., ploteson kerkesen e autoritetit kontraktor ne dokumentat e tenderit ne lidhje me shlyerjen e taksave vend ore per vitet 2017, 2018.*
*Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.*
*III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit "I.D.K KONSTRUKSION" sh.p.k, se; "[ ... ] Dyshojme se Operatori Ndregjoni shpk, pjese e BOE "R.S & M+Sl.Sl-AL+NDREGJONI" nuk ka paraqitur licencen perkatese konform legjislacionit shqiptar [...], Komisioni i Shqyrtimit te Akeses veren se:*
*III.2.1. Ne dokumentat e tenderit, Shtojca 12, kriteret e vecanta te kualifikimit, Pika 2.3.2, e kapacitetit teknik eshte kerkuar:*
*Operatoret ekonomike duhet te disponojne licencat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licencen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministratve Nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedural e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Shqyrtimi i licencave do te behet mbi bazen rregullave të parashikuara sa me siper. Licence profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:*
*• NP-I/A Punime germimi ne toke.*
*• NP-2/A Ndertime civile dhe industriale.*
*• NP- 4/A Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*
*• NS- 1/A Punime per prishjen e ndertimeve*
*• NS- 6/B Sinjalistika rrugore jondricuese*
*• NS- 7/A Barriera dhe mbrojtje rrugore*
*(Shoqerite e huaja duhet te bejne ekuivalentimin e licencave profesionale qe disponojne të leshuara nga vendi i origjines, prone Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, Republika e Shqiperise, konform legjislacionit shqiptar ne fuqi). "*

*III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te bashkimit te operatoreve ekonomike BOE "R.S & M+Sl.SI AL+NDREGJONI" rezulton se, eshte paraqitur dokumenti Kontrate Bashkepunimi e noterizuar, ndermjet shoqerise " R.S & M " sh.p.k. , shoqerise " SI.SI-AL" sh.p.k. dhe shoqerise ,; Ndregjoni " , nga ku shoqeria · R.S & M' sh.p.k. merr persiper te kryeje 59 % te punimeve, shoqeria·' SI.SI-AL " sh.p.k. merr persiper te kryeje 20% te punimeve dhe shoqeria "Ndregjoni" merr persiper te kryeje 21 % te punimeve. Gjithashtu eshte paraqitur edhe dokumenti Prokure e Posacee, sipas se ciles shoqeria "R.S & M" sh.p.k. eshte perfaqesuese e ketij bashkimi operatoresh ekonomike.*
*III.2.3. Nga verifikimi i kryer tek dokumentat e hedhura ne sistemin elektronik te prokurimit, rezulton qe ne permbushje te ketij kriteri, ofertuesi "Ndregjoni " sh.p.k , ka paraqitur:*
*Licencen NZ.1981/18 e regjistuar ne regjistrin themeltar qe nga data 18.03.2019, pa afat kohor ku evidentohet qe Shoqeria "Ndregjoni" sh.p.k ka dorezuar licencen profesionale per ekzekutimin e puneve, te pakten me kategorite dhe klasifikimin perkates :*
*• NP-1/E*
*• NP-2/G*
*• NP- 4/F*
*• NS- 1/D*
*• NS- 6/C*
*• NS- 7/B*
*III.2.4. Ne Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatoreve ekonomike", pika I e VKM nr.914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: "Oferta mund te paraqitet nga nje bashkim operatoresh ekonomike, ku njeri prej te cileve i perfaqeson te tjeret gjate procedures dhe ne rast perzgjedhjeje edhe gjate zbatimit te kontrates, Ne oferte duhet te percaktohet pjesa e sherbimit, punes ose furnizimit, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi". Ne Kreun VIII, neni 74, pika 2 po ketu, parashikohet: "Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonoeike, anetaret e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes, Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi ..', ndersa ne piken 3 parashikohet: "Secili prej anetareve te ketij bashkimi duhet te permbushe kerkesat ligjore, te parashikuara ne nenin 45 te LPP dhe ato te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet te permbushen nga i gjithe bashkimi, ne perputhje me perqindjen e pjesemarrjes ne pune, sherbie apo fumizim, te percaktuara ne aktearreveshje".*
*III.2.5. Ne nenin 46, pika 1, te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: [...].*
*III.2.6. Ndersa ne nenin 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar parashikohet se [...].*
*III.2.7. Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, germa "a", percaktohet se: [...].*

*III.2.8. Ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 66, pika 3, percaktohet se: [...].*

*III.2.9. Komisioni i shqyrtimit te ankeses (KSHA) , sqaron se, kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjeseearres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonoeike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme.*

*Farke; Farke e Vogel; Rruga Daxhit, Zona Kadastrale Nr. 1605, numri i pasurise 210/10 dhe 210/11, Tirane. Sipas Numri i ceshtjes: CN- l 45098-03- l 9 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve Nr. 2 date 27.03.2019 per miratimin e hapjes se nje adrese dytesore. Per kete adrese nuk ka paraqitur vertetim.*

*Nga ana e KVO-se nuk eshte vleresuar sic duhet ky kriter. Por, dhe KSHA-ja ka manipuluar faktet duke e mare te mirqene faktin qe ky operator ka paguar taksat sipas vertetimit te paraqitur nga Bashkia Tirane, per nje adrese tjeter. Bazuar ne legjislacionin per taksat vendore, cdo OE paguan taksa te vecanta per cdo vend te ushtrimit te aktivitetit. Ne rastin konkret ky OE nuk ka paguar taksat vendore (nuk ka paraqitur vertetim) per adresen Farke; Farke e Vogel; Rruga Daxhit, Zona Kadastrale Nr. 1605, numri i pasurise 210/10 dhe 210/1 l, Tirane, sipas QKB-se. Pra ky operator nuk ka plotesuar kete kriter duke mos paguar taksat vendore sipas legjislacionit. (Per Tiranen jane ne nje vlere mbi 300 mije leke per cdo vendushtrimi aktiviteti).*

*3.2 Ne piken 2.3.2 te kritereve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; ... Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje: 2.3/2 Licence te vlefshme te shoqerise, per zbatim te punimeve (konform VKM-se nr. 42 date 16.01.2008, e ndryshuar) me kategorite e meposhtme. [ ... ] Shqyrtimi dhe vleresimi i licencave duhet te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne VKM-ne e siperpermendur. Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri, Operatori Ndregjoni shpk ka paraqitur licensen perkatese ku drejtues ligjor eshte vetem z.Xhetan Ndregjoni.*

*Sipas ekstraktit te QKB-se drejtues ligjor qe nga data 20.03.2019 edhe z. Bledar Alstafa. Pra verehet se, ka mosperputhje te drejtuesit ligjor te pasqyruar ne license me drejtuesin ligjor sipas ekstraktit te QKB. Ne kreun III "Kategorizimi dhe klasifikimi i licences, eleeentet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 gerea "a", paragrafi 2 te VKM, nr.42, date l6.l.2008" parashikohet se: 2. Elementet e licences: a) Licenca permban keto elemente: I. Kategorite e punimeve te ndertimit (percaktuar ne lidhjen nr.2); II. Klasifikimin me nivele per cdo kategori (percaktuar ne lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV. Daten e regjistrimit ne Regjistrin Themeltar (e njejte me daten e marrjes se vendimit nga komisioni); V Emrat e drejtuesve ligjore e teknike; VI. Seline; VII. Afatin e vlefshmerise; VIII. Elementet e sigurise te percaktuara me urdher te ministrit; IX. Te dhenat e plota te kategorive dhe klasifikimit, ne pjesen e pasme te licences (Lidhjet 2 e 4 te kesaj rregulloreje). "[...] Ne kreun I "Qellimi, fusha e veprimit te rregullores dhe perkufizime" pika 2 te VKM Nr.42, date 16.l.2008 parashikohet se: "Drejtues ligjor"-personi fizik apo personal fizike (administrator per sh.p.k., drejtor, presidenti per sh.a., personi fizik) te percaktuar si te tille nga vendimi i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimiti ose ne gjykate Kreu II, pika 5, ku thuhet "Brenda 30 diteve, cdo subjekt i licencuar ne zbatim ka detyrimin te depozitoje aplikimin per perditesimin e te dhenave qe nuk sjellin ndryshim ne klasifikim ... I Ndryshim apo shtese te drejtuesit Ive ligjor te shoqerise; dhe ne vijim kreu VII percakton se "Shoqeria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit te caktuara ne kete rregullore. Ne kete rast komisioni heq licencen per shoqerine/drejtuesit per nje periudhe 3 vjet".*

*Licenca e paraqitur nga ky subjekt megjithese eshte leshuar nga institucioni pergjegjes shfaq te meta dhe nuk permbush te gjithe detyrimet ligjore te parashikuara nga akti noreativ ne zbatim te ligjit, VKM Nr.42, date 16.1.2008 "Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi". Kjo sepse; z. Bledar Alstafa eshte emeruar administrator me date 20.03.2019 dhe referuar detyrimeve te mesiperme ligjore, OE duhej qe brenda dates 19.04.2019*

*(brenda 30 diteve) te pasqyronte ndryshimet perkatese ne licensen e shoqerise. Por, megjithese ka kaluar afati ligjor per te pasqyruar ndryshimet ne drejtuesit ligjore, ai nuk ka bere ndryshimin e kerkuar nga baza ligjore ne fuqi. Perputhja e drejtuesve ligjore sipas QKB-se dhe licenses se shoqerise nuk kushtezohet e nuk lidhet me kompetencat qe sipas statutit i eshte caktuar njerit apo tjetrit administrator. VKM dhe ligji 9901/2008 "per shoqerite tregetare" e percakton qarte se, secili administrator, pavaresisht kompetencave eshte drejtus ligjor dhe si i tille duhet te jete medoemos edhe ne licensen e shoqerise. Referuar pikes 5 germes (a) dhe (b) te Kreut II te VKM nr 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", eshte detyrim ligjor i cdo subjekt te licencuar ne zbatim qe te aplikoje per perditesimin e te dhenave.*

*Ne rregullat e prokurimit percaktohet se, operatoret ekonoeike jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne legjislacionin ne fuqi si edhe kriteret e kualifikimit te vendosur nga autoriteti kontraktor. Shqyrtimi dhe vleresimi i licencave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne sa me siper (pra VKM nr 42 date 16.1.2008). Per sa me siper, dokumentacioni i paraqitur nga ky subjekt, ne kete procedure prokurimi, nuk ploteson kerkesat legjislacionit ne fuqi dhe nuk mund te konsiderohet i vlefshem. I njejti qendrim eshte mbajtur rigorozisht ne praktiken e vendimarrjeve te tjera te Autoritetit Rrugor Shqiptar, po keshtu dhe te KPP-se si organi me i larte administrativ ne fushen e prokurimeve sic jane vendimet 55/2016; 203/2016 dhe 502/2017.*

*3.3 VKM-ja nr 42, date 16.0 I .2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", ne kreu IV, "Drejtuesi teknik i shoqerise dhe papajtueshmeria me kete detyre" pika 2, percakton: Drejtuesit teknike te shoqerise nuk mund te jene personal qe jane te angazhuar ne cdo punemarrje tjeter publike. Drejtuesi teknik i shoqerise nuk mund te jete njekohesisht i punesuar ne dy apo me shume shoqeri ndertimi dhe ndalohet te disponojne licence per mbikeqyrje e kolaudim te punimeve te zbatimit.*

*Kur personat qe pranojne te kryejne detyren e drejtuesit teknik: te shoqerise per zbatim disponojne licence profesionale mbikeqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kane detyrimin per evidentimin e ketij fakti ne dokumentacionin e paraqitur per aplikim, si dhe dorezimin e kopjes origjinale te ketyre licencave prone arkives se sektorit pergjegjes per licencimin, perpara ose ne castin kur shoqeria ne fjale merr licencen.*

*Nga informacionet qe disponohen nga ana jone rezulton qe te pakten njeri prej tyre, z. Shaban L, rezulton i punesuar te pakten dhe ne 10 subjekte te tjera, si: Cani shpk, Yldon shpk, Zguri shpk, Besa shpk, Ndreu shpk, Albta shpk etj. Qofte vetem kjo shkelje e ben licencen e OE Ndregjoni shpk, pjese e ketij bashkimi, te pavlefshme.*

*KSHA-ja ne kete rast nuk ka dhene asnje pergjigje per faktet e cituara nga ana jone.*

*3.4 BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi nuk ka arritur te permbushe kriterin e percaktuar ne piken 2.3.13, ku thuhet: [...] Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike, kandidatet/ofertuesit duhet ti permbahen nenit 74 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", e ndryshuar [...]. Neni 74/2, "Bashkimi i operatoreve ekonomike". Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit,*

*perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetare e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. […]*

*Sipas te dhenave qe disponohen nga ana jone, rezulton qe marreveshja e bashkepunimit te mos jete bere ne perputhje me kete percaktim. Pra, nuk eshte ndare ne elemente konkrete sic kerkohet me siper, po thjesht ne zera shume pergjithshme punimesh. Jo vetem kaq, por nje nder keta zera punimesh nuk eshte marre perisper nga asnje prej antareve pjese e ketij bashkimi operatoresh ekonomik. Ne keto kushte kur punimet nukjane marre persiper te kryehen ne masen 100%, BAO skualifikohet automatikisht.*

*3.5 BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi nuk ka arritur te permbushe kriterin e percaktuar ne piken 2.3.11, "Si deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t 'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten, kandidati/ofertuesi duhet te paraqese: […]*

*Makineri per aplikim vijezimi termoplastik, kapacitet mbajtes te bojes mbi 4.5 ton, pronesi ose qira, Cope 2 [...].*

*Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur Jane dokumentacioni qe verteton pronesine e mjetit: certifikaten te paraqitet qarkullimit; certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshem te mjetit; Iejen e transportit qe lesholtet nga njesia vendore dh e fotot perkatese; Per mjetet qe nuk shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet kontrata e blerjes apo fatura e zhdoganimit, fotof dhe fatura tatimore perkatese.*

*Per mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata noteriale e qirase, e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.*

*Sipas te dhenave qe kemi marre prane DPSHTRR-se rezulton qe Makineri per aplikim vijezimi termoplastik, kapacitet mbajtes te bojes mbi 4.5 ton, ne vendin tone jane te regjistruara vetem tre mjete te tilla. Si rrjedhim i kesaj, e vetmja force disponimi eshte qeraja nga jashte vendit. Paraqesim verejtjet tona nese keto kontrata jane noteriale, sic kerkohet ne DST, pra qe noteri te vertetoje disponimin e mjetit dhe a rezultojne te jene te certifikuara "Apostille", ne perputhje me kriterin 2.3.12 te DST-ve. Ne te kundert kerkojme te verifikohen kontratat origjinale nga ana juaj, pasi sic jemi mesuar tashme mjetet e marrra nga jashte rezultojne kryesisht deklarime te rreme per qellime kualifikimi.*

*Sipas informacionit qe na eshte dhene ne shqyrtimin e ankeses nga KSHA-ja, konstatojme qe makinerite e mesiperme jane marre me qera nga nje subjket i huaj. Ne kete rast, bazuar ne kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, duhet qe kontrata e qerase te jene noteriale, dhe mbi vulen e aktit noterial te jete certifikata "Apostille", qe dokumentacioni i mesiperm te jete i vlefshem. Ne kete rast konstatojme qe ky dokumenatcion nuk eshte paraqitur dhe ky kriter nuk plotesohet nga ky BOE.*

*3.6. BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi, rezulton te kete nderhyre ne preventivin e dhene nga AK-ja, dhe do te mjaftonte vetem kjo arsye per skualifikim nga kjo procedure prokurimi. Ne hartimin e tij nuk eshte respektuar baza ligjore dhe pikerisht VKM-ja nr.514, date 15.8.2007, "Per informatizimin e llogaritjes se kostos dhe*

*hartimin e manualeve teknike te ceimeve te punimeve te ndertimit", i ndryshuar, qe ne piken 12 percakton: Te gjitha institucionet shteterore, qe kryejne prokurime te punimeve te ndertimit me fonde publike, nga Buxheti i Shtetit apo nga donatore te huaj, detyrohen te kontrollojne cmimet per zerat e punes, te ofertave te paraqitura ne tender, me cmimet e bazuara ne manualin e cmimeve te ndertimit dhe ne analizat teknike te ketyre cmimeve. Ne rastin kur zeri i punes nuk figuron ne manual, institucioni u kerkon subjekteve ofertuese te paraqesin analizen teknike, bazuar ne metodologjine e percaktuar ne udhezimin nr. 2, date 8.5.2003 te Keshillit te Ministrave dhe te paraqitur me formalin e unifikuar. Nje fotokopje te analizave te paraqitura nga subjektet ofertuese per zerin e punes, institucioni ia dergon ministrise, e cila e shqyrton analizen e re dhe nese e gjykon te drejte, e reflekton cmimin ne manualin e cmimeve te periudhes vijuese…*

*KSHA-ja, ne pergjigjen e dhene ndaj nesh nuk ka konkluduar ne faktin qe preventivi i dhene ne oefrten e ketij BOE, ne ndarjet, sasi dhe njesi, eshte i njejte me ate ne dokumentetet e tenderit. Ndryshimi i sasive apo njesive matese eshte kusht skualifikimi i menjehereshme qe AK-ja nuk e ka zbatuar.*

*3.7 Bashkimi te perkoheshem i shoqerive, nuk permbush kriterin e percaktuar ne piken 2.3 te Dokumentave Standarte te Tenderit, Kapaciteti Teknik.... Deshmi se ka th realizuar pune te ngjashme per te njejtin objekt, ne raport me perqindjen e pjesemarjes se tij ne bashkim, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.*

*Nga verifikimi qe ne kemi kryer ne Buletinin e Njoftimeve Publike te Agjencise se Prokurimit Publik, te dhenat e deklaruara ne faqen zyrtare ëëë.opencorporates.al mbi eksperiencen e deritanishme te ketij subjekti duke nisur nga viti 2016 e ne vijim, konstatoje se te vetmet kontrata publike te lidhura nga shoqeria "SI- SI -AL" shpk jane ato te cilat jane kryer ne bashkepunim me shoqerine "RS&M" shpk ku % me te madhe ne kontratat e bashkepunimit e ka kjo e fundit. Ne lidhje me permbushjen e kriterit te mesiperm kemi dyshime te arsyeshme, se anetari i bashkimit te operatoreve ekonomike "SI SI AL" shpk nuk permbush kapacitetin teknik deshmi te kontratave te ngisahme.*

*Shoqeria "SI SI AL" shpk, nuk disponon kontrata te ngjashme ne perputhje me zerat e preventivit dhe % e bashkepunimit te marre persiper, pasi kontratat e saj kryesisht jane furnizime mallrash, te cilat nuk mund te konsiderohen te ngjashme ne punime te sinjalistikes, ose kontrata te realizuara ne sektorin privat, por qe nuk jane shoqeruara me te gjithe dokumentacionin e kerkuar nga AK-ja.*

*3.8 AK-ja ne cdo rast duhet qe te beje vleresimin ne baze te kritereve te hartuara ne dokumentat e tenderit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per perebushje me sukses te kontrates, Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme, ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit.*

*3.9. Rrjedhimisht, sa me siper argumentuam qe vendimi i AK-se, ne lidhje me kualifikimin e BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, eshte kryer ne kundershtim me rregullat e prokurimit publik, dhe si i tille duhet te skualifikohet.*
*3.10. Referuar frymes se legjislacionit per prokurimet publike vendosja e kritereve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe t i sherbeje autoritetit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapacitetetеve te operatorit ekonomik te cilet nepermjet dokumentacionit te paraqitur vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besuesheerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshee, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Nenvizojme faktin se ne nenin 53 pika 3 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" parashikohet se Autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitlta kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percakiimet e nenit 54 te ketij ligji.*

II.7. Në datën 10.12.2019, nëpërmjet shkresës me nr.10925/1 prot., datë 05.12.2019, me objekt: "*Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Punime ndërtimi për eleminimin e Pikave të Zeza në rrugë (Bashkëfinancim IPA 2013, Siguria Rrugore)",* është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "I.D.K Konstruksion" sh.p.k.

**III**

**Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. me arsyetimin se *"3.4 BOE RS & M shpk & SI.SI-AL shpk & Ndregjoni shpk, si ofertues ne kete procedure prokurimi nuk ka arritur te permbushe kriterin e percaktuar ne piken 2.3.13, ku thuhet: [...] Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomike, kandidatet/ofertuesit duhet ti permbahen nenit 74 te VKM-se nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", e ndryshuar.[...]. Neni 74/2, "Bashkimi i operatoreve ekonomike". Para dorezimit te ofertes, bashkimi duhet te krijohet zyrtarisht, me nje marreveshje te noterizuar, ku te percaktohen perfaqesuesi i grupit, perqindja e pjesemarrjes se punes/sherbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, qe do te kryeje secili nga anetaret e ketij bashkimi. Pas krijimit te bashkimit te operatoreve ekonomike, anetare e bashkimit caktojne me prokure perfaqesuesin e tyre per dorezimin e ofertes. Kjo marreveshje e shkruar dhe prokura duhet te dergohen se bashku me kualifikimet dhe oferten ekonomike, e cila duhet te nenshkruhet nga perfaqesuesi. [...]*

*Sipas te dhenave qe disponohen nga ana jone, rezulton qe marreveshja e bashkepunimit te mos jete bere ne perputhje me kete percaktim. Pra, nuk eshte ndare ne elemente konkrete sic kerkohet me siper, po thjesht ne zera shume pergjithshme punimesh. Jo vetem kaq, por nje nder keta zera punimesh nuk eshte marre perisper nga asnje prej antareve pjese e ketij bashkimi operatoresh ekonomik. Ne keto kushte kur punimet nukjane marre persiper te kryehen ne masen 100%, BAO skualifikohet automatikisht."*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 12, *"Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit"*, të dokumentave të tenderit përcaktohet:
*Veç kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:*
*a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;*
*b. Prokura e posaçme.*
III.1.2. Në shtojcën 12, *"Kriteret e veçanta të kualifikimit"*, pika 2.3.13 e *"Kapacitetit teknik"* të dokumentave të tenderit përcaktohet:
*"2.3.13 Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t`i përmbahen nenit 74 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar dhe në rastin e nënkontraktimit nenit 75 të kësaj të fundit. "*
III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se është paraqitur si më poshtë vijon:

- Dokumenti "Kontratë bashkëpunimi", Nr.5027 Rep., Nr.1838 Kol., datë 21.10.2019
  Në këtë kontratë bashkëpunimi në nenin 4 të saj *"Detajet e marrëveshjes",* është përcaktuar se:
  *Pjesa përkatëse e secilës prej palëve në zbatimin e Kontratës do të jetë:*

1. *"R.S&M" sh.p.k. do të realizojë 59 % të punimeve të Kontratës që përfshijnë përkatësisht zërat:*
- *Vijëzime me bojë termoplastike;*
- *Tabela Rrugore + Atrecaturë;*
- *Rrethim rruge me rrjetë teli.*

2. *"SI.SI-AL" sh.p.k., do të realizojë 20 % të punimeve të Kontratës që përfshijnë përkatësisht zërat:*
- *Tabela;*
- *Vijëzime me bojë bikomponente;*
- *Barriera (Guardiel).*

3. *"Ndregjoni" sh.p.k., do të realizojë 21 % të punimeve të kontratës që përfshijnë përkatësisht zërat:*
- *Ndërhyrje në rrugë.*

Bashkëngjitur kontratës së bashkëpunimit është edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, ku deklarohet se përfaqësuesi i këtij bashkëpunimi të shoqërive do të jetë shoqëria "R.S&M" sh.p.k.

Gjithashtu konstatohet së në sistemin e prokurimeve elektronike është paraqitur dokumenti me emërtimin Ofera ekonomike.

III.1.4. Në nenin nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*".

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .*"

III.1.5. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar, parashikohet: *"Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi"*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokure përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi…",* ndërsa në pikën 3 parashikohet: "*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje*".

III.1.6. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.7. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: *"[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe*

*besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës […]".*

III.1.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se në marrëvshjen e bashkëpunimit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. *"nuk është ndarë në elementë konkretë sic kërkohet më sipër, po thjesht në zëra shumë përgjithshme punimesh",* KPP nga shqyrtimi i kontratës së bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k., rezulton se në këtë dokument në nenin 4 të tij, janë përcaktuar përqindjet e marra përsipër nga secili operator në këtë bashkim. Konkretisht, operatori ekonomik "R.S&M" sh.p.k. do të realizojë 59 % të punimeve të kontratës që përfshijnë përkatësisht: - Vijëzime me bojë termoplastike; - Tabela Rrugore + Atrecaturë; - Rrethim rruge me rrjetë teli. Operatori ekonomik "SI.SI-AL" sh.p.k., si një nga anëtarët e këtij bashkimi do të realizojë 20 % të punimeve të kontratës që përfshijnë përkatësisht: - Tabela; - Vijëzime me bojë bikomponente; -Barriera (Guardiel). Ndërsa, operatori ekonomik "Ndregjoni" sh.p.k., si një nga anëtarët e këtij bashkimi do të realizojë 21 % të punimeve të kontratës që përfshijnë përkatësisht: - Ndërhyrje në rrugë.

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, KPP nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k., konkretisht kontratës së bashkëpunimit, konstatohet se, punët e marra përsipër nga secili anëtarë i këtij bashkimi nuk janë përcaktuar në përputhje me të gjitha zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në preventivin e punimeve të kësaj procedure prokurimi. Pra, në kontratën e bashkëpunimit të operatorëve ekonomikë për të cilët ngrihen pretendime, nuk përcaktohet qartë se cilat zëra të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, do të marrë përsipër secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Sqarojmë se bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, është përcaktuar qartësisht që para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.

Në kuptim të sa më sipër, në marrëveshjen e noterizuar duhet të përcaktohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit, si edhe elementët konkretë që do të kryejë secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Pra, marrëveshja e noterizuar, që të konsiderohet e saktë e në përputhje me legjislacionin në fuqi, përbëhet nga disa të dhëna, një prej të cilave është edhe përcaktimi i elementëve konkretë të zërave të punëve që do të kryhet nga secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, pra elementët konkretë duhet të jenë të përcaktuar në marrëveshjen e noterizuar (të detajuar e përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit, si pjesë e neneve të saj në vijim ose pjesë integrale e saj), mjafton që të jetë në marrëveshjen e noterizuar. Ndërkohë që kjo ndarje e detajuar mungon dhe nuk është pjesë integrale ose e shprehur, në marrëveshjen e noterizuar të bashkëpunimit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në marrëveshjen e bashkëpunimit, ashtu siç edhe përcaktohet në legjislacionin në fuqi, përpara noterit, përcaktohen të gjitha të dhënat sic janë

përqindja e bashkëpunimit si edhe zërat/elementët konkretë që do të marrë përsipër për të kryer secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë.
Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.
Sa më sipër, bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k., nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë në përputhje me dokumentat e tenderit dhe nenin 74 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, i ndryshuar. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.
Dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik "I.D.K Konstruksion" sh.p.k., mbi kualifikimin e padrejtë të bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë "R.S & M" sh.p.k. & "SI-SI AL" sh.p.k. & "Ndregjoni" sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave* "*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "I.D.K Konstruksion" sh.p.k. për procedurën e prokurimit *"Procedurë e hapur"*, me nr. *REF-35460-09-10-2019*, me objekt *"Punime ndërtimi për eleminimin e Pikave të Zeza në rrugë (Bashkëfinancim IPA 2013, Siguria Rrugore)",* me fond limit 39.045.776,98 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 21.10.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “R.S & M” sh.p.k. & “SI-SI AL” sh.p.k. & “Ndregjoni” sh.p.k., dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “I.D.K Konstruksion” sh.p.k.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1780 Protokolli**
**Datë 20.11.2019**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Nënkryetar | Anëtar | Anëtar | Anëtar |
|---|---|---|---|
| **Enkeleda Bega** | **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Kryetar**
**Evis Shurdha**